



**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË**

Tiranë, 26 dhjetor 2023

**RAPORT VJETOR I INSTITUTIT TË HISTORISË PËR VITIN 2023.
PARASHIKIMIN E VEPRIMTARISË PËR VITIN 2024**

Viti 2023 ka qenë një vit i vështirë për aktivitetin shkencor dhe institucional të Institutit të Historisë. Në maj 2023 Këshilli i Ministrave miratoi vendimin 338/2023 për shkrirjen e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e instituteve pranë Akademisë së Shkencave. Vendimi nuk pati impakt në kalendarin vjetor shkencor dhe as në punën kërkimore individuale të studiuesve të IH, por në klimën e përgjithshme të aktivitetit, zhvendosjen e vëmendjes publike tek debati mbi impaktin e mbylljes së ASA dhe shqetësimet mbi lirinë akademike dhe ardhmërinë e instituteve. Deri në analizën vjetore të Institutit të Historisë, zhvilluar më 26 dhjetor 2023, ende nuk ishte miratuar VKM përkatëse, e cila do të duhej të ligjërojë institutet si njësi kërkimore afatgjatë, në kuadrin e legjislacionit rregullator të Akademisë së Shkencave.

Procesi i transferimit të instituteve të ASA tek ASH përfundon më 31 dhjetor 2023, por vonesat e krijuara, paqartësitë ligjore dhe mungesa e transparencës dhe e konsultimit midis institucioneve solli klimë të tensionuar dhe konfuzion, pengesa dhe vonesa në ushtrimin e funksioneve të ASA, ku Instituti i Historisë bën pjesë. Po ashtu aktiviteti i Institutit dhe disa aspekte të lirisë akademike u vunë nën presion publik përmes deklaratave të zyrtarëve mbështetës të mbylljes së ASA, si dhe shpesh edhe nga struktura burokratike brenda ASA. Pafuqia e strukturës drejtuese në ASA për të administruar, shpërndarë dhe promovuar botimet cilësore të Institutit të Historisë, si dhe tendenca të njëjta edhe nga institucione të rëndësishme, përfshirë Ministria e Arsimit dhe e

Rinisë, përbëjnë një nga pengesat në punën dhe aktivitetin e Institutit, pengesë që nuk ka ende garanci se do të evitohen në të ardhmen me kalimin nën Akademinë e Shkencave.

Pavarësisht nga situata e krijuar Instituti i Historisë si institucion dhe stafi kërkimor i IH i jetësuan të gjitha aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2023 dhe arritën të kenë arritje profesionale në angazhimet e tyre kolektive dhe individuale.

Konkretisht,

- I. Gjatë vitit 2023 Instituti i Historisë përfundoi përgatitjen dhe publikoi pesë vëllimet **“Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX”**, botimi më i rëndësishëm në fushën e historisë gjatë më shumë se dy dekadave. Botimi përbën arritje shkencore të stafit aktual të IH, ekipit realizues të drejtuar nga Prof. Beqir Meta, të rreth 40 studiuesve të përfshirë në procesin e shkrimit dhe redaktimit të vëllimeve, si dhe të vetë ASA, si institucioni kryesor në vend në fushën e studimeve albanologjike. Botimi u prezantua më 30 tetor 2023 në prani të studiuesve të historisë, stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve. Në ceremoni mori pjesë dhe përshëndeti edhe Presidenti i Republikës z. Bajram Begaj.
- II. Gjatë këtij viti **12 kërkues shkencorë** në Institutin e Historisë patën në dispozicion dhe shfrytëzuan fonde financiare për kërkim shkencor në arkivat e vendeve të ndryshme (**Itali, Britani, Turqi, Serbi, Bullgari, Kroaci, etj**), ose për pjesëmarrje dhe promovim shkencor në konferenca ndërkombëtare në vende të ndryshme (Austri, Francë, Britani, Kroaci, Greqi, Turqi, Itali, etj). Financimi u mundësua në kuadër të jetësimit të fazës së parë të projektit “Historia përmes dokumenteve: Fonde të reja për Shqipërinë, kërkim dhe promovim”, miratuar nga Bordi i Administrimit në ASA.
- III. IH përgatiti, përpunoi dhe **publikoi online faqen e re të “Studime Historike”, (<https://ih-revista.edu.al/>)** revista kryesore shkencore në studimet historike në Shqipëri. Publikimi u shoqërua me plotësimin e kriteve të indeksimit, përpunimin e të gjithë numrave të revistës nga 1964 dhe në vijim, si dhe hyrjes në fazën e aplikimit për SCOPUS.
- IV. Instituti regjistroi një numër të lartë botimesh profesionale, përfshirë edhe botime jashtë vendit, si dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Gjashtë studiues realizuan kapituj të posaçëm në vëllimin V të Historisë, i cili botohet duke sjellë kontribute që mbulojnë për herë të parë periudhën 1945-2000. Paralelisht Instituti botoi 4 monografi, disa të tjera janë në procesin përmbyllës, ndërsa të gjithë studiuesit raportuan vijimin e punës kërkimore për monografitë në proces në përputhje me periudhën kalendarike të kontratës. IH botoi gjithashtu 9 vëllime dokumentare lidhur me periudha të ndryshme historike (vitet 1913-1914, vitet 1950-1951, si dhe 1990), si dhe dy botime të akteve të konferencave shkencore.

PËRMBLEDHJE E PRODUKTIT SHKENCOR

Tabela më poshtë paraqet në formë statistikore produktet shkencore kryesore të stafit të Institutit të Historisë gjatë vitit 2023. Pjesë e tabelës nuk janë aktivitete institucionale dhe dytësore të secilit studiues, si dhe angazhime të tjera që vijnë në kuadër ndërinstitucional, ndërkombëtar, si dhe në komisione, grupe pune dhe redaksi botimesh në Shqipëri, Kosovë, etj.

BILANCI STATISTIKOR I BOTIMEVE 2023	NUMËR
BOTIM SPECIAL: HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX	I, II, III, IV, V
MONOGRAFI TË BOTUARA	4
MONOGRAFI NË PROCEDURË VLERËSIMI	1
MONOGRAFI NË PROCES	16
VËLLIME DOKUMENTARE / PËRKTHIME TË BOTUARA	9
KRITIKË DHE REDAKTIME SHKENCORE	35
REFERIME NË KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE (BE +)	15
REFERIME NË KONFERENCA DHE AKTIVITETE SHKENCORE KOMBËTARE	19
REFERIME NË KONFERENCA DHE AKTIVITETE SHKENCORE (KOSOVË/MAQEDONI V/MALI I ZI)	29
BOTIME NDËRKOMBËTARE (KAPITUJ LIBRI)	2
ARTIKUJ SHKENCORË (VENDET E BE/OECD)	8
ARTIKUJ / KUMTESA NË “STUDIME HISTORIKE” / “ALBANIAN STUDIES”, “KOSOVA”	23
RECENSA SHKENCORE (BOTIME)	8

PARAQITJA E AKTIVITETIT SHKENCOR DHE PROFESIONAL TË INSTITUTIT TË HISTORISË (2023)

Aktiviteti i Institutit të Historisë është i bazuar në aktet rregullatore të brendshme (Rregullore e Institutit dhe Statuti i ASA), si dhe kategorizimi i botimeve dhe aktivitetit shkencor (MASR). Bazuar në këto kritere më poshtë paraqiten në formë më të detajuar bilanci i punës i stafit kërkimor të Institutit të Historisë.

A. KËRKIMI SHKENCOR

I. PJESËMARRJE NË PROJEKTE SHKENCORE

A. *Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim shkencore kolektive (PKKZh – AKTI), nga Protokolle të bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik dypalësh (MASR dhe AKTI) dhe programe të tjera (Cilësi dhe Barazi në Arsim, Banka Botërore dhe MAS, etj.)*

PROJEKTE MADHORE STUDIMORE

I. **Projekti shkencor: *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*”, Vëllimi V**

- **Sonila Boçi.** *Ka shkruar pjesën për marrëdhëniet shqiptaro-italiane gjatë viteve 1960-1990 (34 faqe).*
- **Afrim Krasniqi.** *Ka shkruar kapitullin për periudhën 1986-2000 (62 faqe), si dhe është recensues i vëllimit V.*
- **Hamit Kaba.** *Ka shkruar kapitullin “Marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA, Britaninë e Madhe, Francën dhe Republikën Federale Gjermane (1949) 1945-1990” (65 faqe).*
- **Ylber Marku.** *Ka shkruar pjesën “Raportet e PPSH me grupet marksiste-leniniste e me organizatat e tjera të ngjashme”, (17 faqe).*
- **Beqir Meta.** *Ka kryer redaktimin shkencor dhe përgatitjen për botim të vëllimit V, si dhe ka shkruar pjesë të veçanta të tij.*
- **Erjon Papagjoni.** *Ka përgatitur “Komuniteti ortodoks dhe pushteti komunist” (6 faqe).*

II. **Projekti i Akademisë së Shkencave: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi IV.** (jashtë planit të punës). Puna ka filluar në maj të vitit 2021 dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2024.

- **Beqir Meta, Ledia Dushku, Sonila Boçi, Hamit Kaba dhe Edon Qesari** kanë vijuar punën për shqyrtimin e burimeve dhe kanë shkruar pjesën e mbetur të materialit, sipas kontratave përkatëse.

III. Projekti i Institutit të Historisë “Ali Hadri”: ***Historia e Kosovës*** vëllimi III, IV.

- **Beqir Meta, Hamit Kaba, Afrim Krasniqi** kanë vijuar punën për shkrimin ose redaktimin shkencor të dy vëllimeve, sipas kontratave përkatëse.

PROJEKTE ME UNIVERSITETET NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje 5 vjeçare me **Qendrën e Studimeve Ndërdisciplinore / Shkolla Doktorale në Universitetin e Oradeas në Rumani.**
2. Marrëveshje bashkëpunimi 5 vjeçare me universitetin **“Aldo Moro”, Bari, Itali**, lidhur me kërkime shkencore, shkëmbime dhe botime. Koordinator Edon Qesari.
3. **Ylber Marku** fitoi projektin shkencor *“Serving the revolution: educational networks in communist Albania”*, si pjesë e Horizon Europe Marie Skłodowska-Curie Actions ose HORIZON-MSCA-2022-PF-01-01 nw Universitetin Ludwig Maximilian në Mynih.
4. **Ardian Muhaj.** *“From the Middle Ages to the Modernity. Historical, Cultural And Linguistic Relations Between Albanians and Romanians”*. Libër studimor në proces, bashkëeditor, botim i Peter Lang, në bashkëpunim me Balkan History Association, Rumani.
5. **Edmond Malaj.** Georg Stadtmüller, *Hulumtime për historinë e hershme të Shqipërisë.* Përgatitja me Albert Ramaj. Bashkëpunim me Albanisches Institut, Zvicër.
6. **Edmond Malaj.** Peter Bartl, *Studime dhe Materiale për historinë e Shqipërisë.* Përgatitja në bashkëpunim me Albert Ramaj. Bashkëpunim me Albanisches Institut, Zvicër.
7. **Romeo Gurakuqi** vijon të jetë i përfshirë në një fellowship program në London School of Economics, Britani e Madhe.
8. **Ardian Muhaj.** Pjesëmarrje në disa sesione online të Akademisë Portugeze të Historisë në përputhje me statutin e përditësuar të kësaj akademie mbi pjesëmarrjen e anëtarëve përmes platformës online.

PROJEKTE NË BASHKËPUNIM ME PARTNERËT E INSTITUTIT TË HISTORISË

Instituti i Historisë realizoi me nismën e vet ose në partneritet, disa konferenca shkencore. Konkretisht,

- I. Dhjetor 2023. Konferencë shkencore **“Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939”**, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT).
- II. Tetor 2023. Konferencë shkencore **“Konferenca e Londrës dhe shqiptarët”**, organizuar nga Instituti i Historisë Kosovë në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë
- III. Shkurt 2023. Konferenca shkencore mbi **15 vjetorin e Pavarësinë e Kosovës**, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Kosovë në bashkëpunim me Institutin e Historisë;
- IV. Maj 2023. Konferencë shkencore **mbi rolin e gruas në historinë e re të Kosovës**, organizuar nga IH Kosovë në bashkëpunim edhe me IH në Tiranë.
- V. Shkurt 2023. Tryezë debati mbi botimin e IH **“Shteti dhe komunitetet fetare”**;
- VI. Mars 2023. Simpozium mbi **botimet kryesore mbi Skënderbeun**, nismë e departamenteve të Mesjetës në IH në Tiranë dhe IH në Kosovë.

- VII. *Nëntor-dhjetor 2003*. Cikël me 8 leksionesh të hapura me disa studiues të historisë nën titullin **“Në Flakë të Revolucionit 1960-1970”**, të ideuara prej tij dhe të organizuara nga Ylber Marku, departamenti i historisë bashkëkohore në bashkëpunim me Dr. Jonida Gashin, përgjegjëse e departamentit të studimit të artit pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore.

PROJEKTE NË TË CILAT ANËTARËT E DEPARTAMENTIT JANË PJESË:

1. **I gjithë stafi i studiuesve** është pjesë e projektit **“Historia përmes dokumenteve 2023-2025”**, financim i ASA me vendim të Senatit dhe Bordit të Administrimit.
2. **Afrim Krasniqi** është angazhuar për pjesën historike në projektin e modernizimit të **Muzeut Kombëtar**. Produkti shkencor është dorëzuar, në pritje për fillimin e restaurimit të plotë.
3. **Beqir Meta, Afrim Krasniqi dhe Hasan Bello** janë angazhuar në projektin e KAS mbi dokumentet historike, **Shteti dhe komunitetet fetare 1945-1990**. Dy vëllime janë botuar, vijon botimi III.
4. **Eduart Caka**. Në kuadër të projektit **“Një studim mbi strukturën politike, ekonomike, demografike, kulturore e fetare të sanxhakut të Elbasanit për shek. XVI”**, mbështetur nga AKKSHI dhe TUBITAK, ka kryer ekspedita arkivore dhe kërkimore terren në Stamboll, Krujë, Durrës, Kavajë, Peqin, Rogozhinë, Elbasan e Librazhd.
5. **Gjon Boriçi** është angazhuar në projektin **“Tirana në sytë e Sigurimit të Shtetit”** në bashkëpunim me AIDSSH, Bashkia e Tiranës. Ai ka përgatitur dhe prezantuar studimin analiza të dy dosjeve, dërguar për botim tek AIDSSH.

C. STUDIME DHE BOTIME (MONOGRAFI)

Gjatë vitit 2023 Instituti i Historisë ka kryer dy monografinë kuadër të ASA, një jashtë saj ose një monografi produkt doktorat në Institutin e Historisë:

1. **Artan Hoxha. Sugarland: The Transformation of the Countryside in Communist Albania** (Budapest-New York: CEU Press, 2023);
2. **Gjon Boriçi. Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze, 1954-1960**, (Tiranë: GEER & ASA, 2023);
3. **Romeo Gurakuqi. Shqipëria dhe Tokat e Lirume, 1939-1946, Revised Second Edition** (Tiranë: Jozef, 2023)
4. **Etleva Smaçi. Shqipëria në Traktatin e Varshavës (1955- 1968): mite dhe të vërteta**. UET Press, 2023. (botuar doktoraturën e mbrojtur në IH/ASA).

C.1. STUDIME TË BOTUARA JASHTË (KAPITUJ LIBRI)

1. **Afrim Krasniqi. *Kosovo and Albania, a special relationship***. Retrospectives and Challenges Toward the Future, pg. 55-75, in Lika, L. (Ed.). (2023). *Kosovo's Foreign Policy and Bilateral Relations* (1st ed.). Routledge.
<https://doi.org/10.4324/9781003371588>
2. **Afrim Krasniqi. *Albania's parliamentary administration***, in: *The Routledge Handbook of Parliamentary Administrations* Routledge, London. 2023,
<https://www.routledgehandbooks.com/doi/10.4324/9781003181521-40>

C.2. MONOGRAFITË NË PROCES

Bazuar në kontratat e punës dhe vendimmarrjet e Këshillave Shkencorë në vite, stafi kërkimor në IH ka vijuar angazhimet për monografite shkencore tri prej të cilave janë parashikuar të botohen gjatë vitit 2024.

Konkretisht,

1. **Afrim Krasniqi** ka vijuar punën për monografinë ***Shqipëria 1986-1992: nga izolimi absolut drejt një shoqërie të hapur***.
2. **Albana Mema** ka vijuar punën për monografinë ***Emigracioni politik shqiptar në vitet 1925-1939***.
3. **Alvin Saraçi** ka vijuar punën për monografinë ***"Konsullata veneciane e Durrësit dhe tregtia me Venecien në gjysmën e parë të shek. XVIII***.
4. **Ardian Muhaj** ka vijuar punën për monografinë ***Marrëdhëniet shqiptaro-angleze nga shekulli XIII deri në fillimin e shek. XX"***,
5. **Artan Hoxha** ka vijuar punën për studimin ***E kuaja dhe e zeza: ateizmi, feja dhe moderniteti në Shqipërinë komuniste***.
6. **Beqir Meta** ka vijuar punës për monografinë ***Minoritetet në Shqipëri 1925-1939, vëll. II)***.
7. **Edmond Malaj** është në fazën fundore për monografinë ***Shqiptarët dhe Republika e Raguzës në Mesjetë***.
8. **Edmond Malaj** ka vijuar punën për monografinë ***Shkodra në Mesjetë***.
9. **Edon Qesari** ka nisur punën për monografinë ***Shqipëria dhe Italia mes Luftërave Botërore: shkëmbime sociale dhe qarkullime kulturore mes dy brigjeve***.
10. **Eduart Caka** ka vijuar punën për monografinë ***Elitat lokale në Shqipëri gjatë shekujve XV-XVII***.
11. **Erjon Papagjoni** ka vijuar punën për monografinë ***Komunitetet fetare në Shqipëri: marrëdhëniet me shtetin dhe mes tyre (1920-1939)***.
12. **Hasan Bello** ka punuar për monografinë ***Arsimi dhe institucionet e huaja arsimore në Shqipëri (shek. XIX-1912)***.
13. **Gjon Boriçi** ka punuar për variantin final të monografisë ***Vendosja e regjimit komunist***

në Shqipëri nëntor 1944 - dhjetor 1949.

14. **Hamit Kaba** ka vijuar punën për studimin ***Shqipëria në orbitën e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) 1945-1961***.
15. **Ledia Dushku** ka vijuar punën për studimin ***Aspekte të pavarësimit, shtetformimit dhe shoqërisë shqiptare (1912-1914)***.
16. **Romeo Gurakuqi** ka punuar rreth studimit ***Marrëdhëniet shqiptaro-britanike 1946-1954***;
17. **Sali Kadria** ka vijuar punën për monografinë ***Zhvillimet politike në Shqipëri (1928-1939)***.
18. **Sonila Boçi** ka vijuar punën me studimin ***Nga rivalë politikë në armiq: metamorfoza e marrëdhënieve midis PKSH dhe Ballit Kombëtar (1942-1944)***.
19. **Ylber Marku** i është bashkuar Departamentit në 1 qershor 2023 dhe ka filluar punën për studimin ***Në shërbim të revolucionit: rrjetet arsimore dhe të ekspertizës në Shqipërinë komuniste***.

D. PËRGATITJE DHE REDAKTIM SHKENCOR I AKTEVE DHE PËRKTHIME/EDITIME

1. **Afrim Krasniqi**. *“Historia dhe historiografia: refleksione mbi Shqipërinë e viteve 1945-1990”*. Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare (ASA / KAS, 2023) ISBN 9789928394323
2. **Afrim Krasniqi**. *“Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane gjatë shekullit XX”*, akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, përgatitur dhe parathënie, ASA, 2023. ISBN 9789928394217
3. **Afrim Krasniqi**. *“Viti 1990 dhe Shqipëria. Viti 1990 në VOA”*. ASA/IH, 2023, përgatitur dhe parathënie, fq. 710 (në proces shtypi).
4. **Beqir Meta, Hasan Bello dhe Afrim Krasniqi** kanë përgatitur dhe botuar *“Shteti dhe komunitetet fetare – dokumente historike, Vëll. II, 1951-1952”*, 666 faqe.
5. **Edmond Malaj** ka përgatitur për botim dhe redaktuar *“Skënderbeu në historiografinë gjermane” (2024)*
6. **Edmond Malaj** ka përkthyer e botuar më 2023 *“Historija e Popullit Shqiptar”* (Tit. o origj. Die Geschichte des Albanischen Volkes), me autor Paulin Margjokaj
7. **Edmond Malaj** ka përgatitur për botim nga doreshkrimi origjinalin që do botohet në gjuhën gjermane *“Die Geschichte des Albanischen Volkes”*, me autor Paulin Margjokaj.
6. **Eduart Caka**. Përgatitur albumin enciklopedik me titull *“Diaspora shqiptare ndër vite (Albanian Diaspora over the years)”*, sponsorizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe botuar nga Mediaprint.
8. **Ledia Dushku** ka përgatitur për botim dhe redaktuar *8 kumtesa që u paraqitën në konferencës “Rruga e shqiptarëve drejt pavarësisë dhe sfidat e procesit të shtetndërtimit”*. Botimi bëhet më 2024.
9. **Ledia Dushku** ka përgatitur për botim dhe redaktuar aktet e konferencës *“Krijimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe roli i Austro-Hungarisë”*. Botimi është në proces.

10. **Marenglen Verli** ka përgatitur për botim dhe redaktuar *“Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913)”*, vëll. II, III. Botuar gjatë 2023.

E. RECENSIONE DHE KRITIKË SHKENCORE

1. **Stafi kërkimor** i IH ka recensuar në total **35 artikuj** në revistat *“Studime Historike”*, *“Kosova”* dhe *“Albanian Studies”*, si dhe në revista shkencore jashtë vendit.
2. **Afrim Krasniqi** ka kryer recensionin për *Historinë e shqiptarëve gjatë shek. XX*, vëll.V.
3. **Beqir Meta ka kryer recensionin** për monografitë e Gjon Boriçit, *“Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze (1954-1960)”*.
4. **Gjon Boriçi** ka përgatitur një recension libri *“Romeo Gurakuqi, Shqipëria dhe Tokat e Lirë 1939-1946*, bot. II i plotësuar, Durrës, Botimet Jozef, 2023).
5. **Hamit Kaba** ka përgatitur një recension libri *“Etleva Smaçi, Shqipëria në Traktatin e Varshavës (1955-1968)*, (Tiranë: UET Press, 2023)
6. **Romeo Gurakuqi** ka përgatitur një recension, *“Jusuf Buxhovit, Maqedonia, nga lashtësia deri në ditët tona*, diskutim organizuar nga ASA prill 2023.
7. **Sonila Boçi** ka shkruar një recension libri: *Ardit Bido, Lufta për 20 përqindëshin: fluiditeti i identitetit, statistikat demokrafike dhe implikimet politike në Konispol dhe Himarë*, (Tiranë: Dudaj, 2023).
8. **Ylber Marku** ka kryer recensionin për librin me dokumente VOA dhe Shqipëria, 1990 edituar nga Afrim Krasniqi.

II. PJESËMARRJE NË VEPRIMTARI SHKENCORE

Gjatë vitit 2023, studiuesit e departamentit të Historisë Bashkëkohore kanë qenë kontributorë në një sërë aktiviteteve shkencore si brenda vendit, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Në mënyrë të përmbledhur, ata kanë marrë pjesë në **15 prezantime në aktivitete shkencore ndërkombëtare; 19 në konferenca dhe aktivitete kombëtare, 29 referime në konferenca shkencore në Kosovë/Maqedonia e Veriut/Mali i Zi.**

C. KONFERENCA DHE AKTIVITETE SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

1. **Afrim Krasniqi.** *“A “proactive” small Albanian State in the Eastern Balkans: Albanian’s external positions and internal challenges since 2013”*, IMS/FSV, Charles University, Prague, February 17, 2023.
2. **Afrim Krasniqi.** *“A Century of Czech(oslovak)-Albanian Relations”*. Në Václav Havel Library and Charles University, Prague, February 16, 2023.

3. **Afrim Krasniqi.** *“Decriminalization process and election integrity: case of Albania”* në konferencën “Integrity of elections”, Co me Dorina Berdufi, organizuar nga EIP, Royal Military College of Canada / Queen’s University) dhe University of East Anglia, mbështetur nga Carter Center, IFES dhe International IDEA, 5-7 korrik 2023.
4. **Artan Hoxha.** *“A Microhistory of the 20th Century: Spatial Transformation, Social Engineering, and the Industrialization of the Albanian Countryside,”* mbajtur në konferencën ndërkombëtare “Winds of Change? Academic and Artistic Perspectives on Experiences of Change in Southeast Europe,” organizuar nga Südosteuropa Gesellschaft në Tützing, Gjermani, 3 tetor 2023.
5. **Artan Hoxha.** *“Sugarland: The Transformation of the Countryside in Communist Albania,”* leksion i paraqitur në ciklin e leksioneve “Balkanforschung an der ÖAÖ”, Akademia e Shkencave të Austrisë, Vienë, 5 dhjetor 2023.
6. **Artan Hoxha.** *“Transforming and Industrializing the Countryside: Contextualizing Communist Albania’s Land of Sugar Within the Framework of the 20th Century,”* leksion i hapur i mbajtur në Leibniz-Institut für Ost- und Südosteuropaforschung, Regensburg, Gjermani, 7 dhjetor 2023.
7. **Artan Hoxha.** *“The Power of Microhistory: Sëamp, Sugar, Communism, Environment,”* leksion mbajtur në Harriman Institute, Columbia University of New York, 5 prill 2023.
8. **Artan Hoxha.** *“The Red and the Black: Atheism, Religion, and Modernity in Communist Albania,”* mbajtur në konferencën ndërkombëtare “Communist Perspectives on Atheism in the 20th Century,” organizuar nga Centre d’étude sociales and religieuses, EHESS, Paris, 13 nëntor 2023.
9. **Eduart Caka.** *“Osmanlı Sınır Bölgelerinin Tarih Yazımında Seyahatnameler: Elbasan Şehri Örneğinde Batılı ve Doğulu Kaynakların Değerlendirilmesi (16.-17. Asırlar)* në Simpoziumin ndërkombëtar me temë: I. Uluslararası Evliya Çelebi Sempozyumu: Seyahat Tarihi ve Kültürü, İstanbul 5-7 Tetor 2023.
10. **Ledia Dushku.** *“The Prince of Albania Wilhelm von Wied and Romanian-Greek diplomatic relations (1913- 1914)”*, në konferencën shkencore ndërkombëtare “Greek-Romanian relations from the decline of the Ottoman Empire to the end of the Cold War era (1821-1989” organizuar nga The Department of Balkan Slavic and Oriental Studies (University of Macedonia), Faculty of History and Geography (Ştefan cel Mare University of Suceava), Balkan History Association, 22-24 nëntor 2023.
11. **Ledia Dushku.** *“World War I and its impact on political events in Albania: The case of Rebellion in Central Albania (1914-1915)”*, në Kongresi i Tretë i Studimeve Osmane organizuar nga nga Balkan Studies Foundation, Istanbul Medeniyet University, International Balkan University, 1-2 shtator 2023.
12. **Sali Kadria.** *“Marrëdhëniet shqiptaro-turke gjatë viteve 1920 – Faktorët nxitës dhe pengues”* në konferencën VII shkencore ndërkombëtare e Egjeut në fushën e shkencave sociale & humane, organizuar në Izmir/Turqi nga Instituti i Zhvillimit Ekonomik dhe Kërkimeve Sociale (IKSAD), 26-27 prill 2023.
13. **Sali Kadria.** *“Pavarësia e Shqipërisë. Çfarë rruge do të ndjekin shqiptarët? Diskursi nationalist pas shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane”*, në konferencën

- shkencore ndërkombëtare “Fqinji i ri – i vjetër: Republika e Turqisë dhe Ballkani”, organizuar në Athinë/Greqi nga Universiteti Panteion, 23-25 nëntor 2023.
14. **Ylber Marku.** Cikël dy ditor i seminareve pranë departamentit të historisë së Ludwig Maximilien Universitet (LMU). Ftuar nga Prof. Marie-Janine Calic, pranë departamentit të historisë së Universitetit Ludwig Maximilien për të marrë pjesë dhe diskutuar prezantimet e punimeve doktorale dhe një punim postdoktoral (artikull) pranë këtij departamenti të cilat kishin në fokus kryesisht periudhën e Luftës së Ftohtë në Europën Juglindore, 22-24 qershor 2023.
 15. **Ylber Marku.** Prezantim i projektit “Serving the Revolution: educational networks in communist Albania” në Universitetin Complutense Madrid. Konferencë ndërkombëtare me temë “Transnational Communism in Cold War Europe”, paneli “Communism in the Balkans”, 30 nëntor – 1 dhjetor 2023.

B. KONFERENCA SHKENCORE KOMBËTARE

1. **Ardian Muhaj.** *“Shkenat e identitetit ne Shqipëri ne epokën e globalizimit. Veçori, kufizime, keqkuptime, problematika”* në konferencën shkencore të organizuar nga Akademia e Shkencave te Shqipërisë dhe Universiteti "Fan Noli", Korçe, mbi letërsitë kombëtarë ne sistemin universitar, Tiranë, 14 nëntor 2023.
2. **Ardian Muhaj.** *“Synimet e politikës detare të Skënderbeut. Përpyekjet për afirmim politik në hapësirën adriatike”*, në konferencë shkencore Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në botimet tona historike: *studime dhe sfida*, Prishtinë, 2 mars. 2023.
3. **Ardian Muhaj.** *“Terminologjia shkencore në historiografi. Mes traditës lokale dhe praktikës bashkëkohore ndërkombëtare”* në konferencën shkencore ndërkombëtare: *Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë*. Organizuar nga Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, 11 Maj, 2023, Tiranë.
4. **Ardian Muhaj.** *“Vendosja e perdes së hekurt për shqiptarët jashtë Republikës së Shqipërisë nga regjimi enverist. Pasojat negative dhe nevoja e kapërcimit të tyre”* në konferencën shkencore ndërkombëtare: *“Shqiptarët dhe Komunizmi”*, organizuar nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë dhe Instituti Sami Frashëri, Tiranë, 15-16 nëntor 2023.
5. **Artan Hoxha.** *“Asfiksimi i bashkësive fetare dhe rruga drejt vitit 1967: Një parahistori e shpalljes së ateizmit shtetëror në Shqipërinë komuniste”*, mbajtur në ciklin e leksioneve të hapura *“Në flakët e revolucionit: Perspektiva të reja mbi Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor – drejt një qasje ndërdisiplinore”*, organizuar nga Instituti i Historisë dhe Instituti i Antropologjisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 17 nëntor 2023.
6. **Beqir Meta.** *“Perceptimet shqiptare ndaj Turqisë gjatë Luftës së Ftohtë”*, në Simpoziumin shkencor ndërkombëtar *“Marrëdhëniet shqiptaro-turke, e kaluara, e tashmja, e ardhmja”*, organizuar në Tiranë nga Fondacioni ALSAR, 15-16 nëntor 2023.

7. **Beqir Meta.** *"Pragmatizmi dhe realizmi i politikës së jashtme shqiptare përgjatë gjysmës së parë të shekullit XX"*, në konferencën shkencore "Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939", organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT), 14 dhjetor 2023.
8. **Edmond Malaj.** *"Historia e Provincës Françeskane Shqiptare nën dritën e hulumtimeve të Donat Kurtit"*, në konferencën shkencore, dhjetor 2023.
9. **Edmond Malaj.** *"Jeta dhe veprimtaria shkencore e Çabejt nën diktaturën komuniste"* në konferencën ndërkombëtare: "Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolegë të gjuhës gjermane". Universiteti i Tiranës, Tiranë, 9 nëntor 2023.
10. **Edmond Malaj.** *"Kontributi i Peter Bartlit për historinë e Dioqezez të Shkodrës gjatë periudhës osmane"* në konferencën ndërkombëtare "Peter Bartl in Memoriam 1938-1922", 29 mars 2023.
11. **Edmond Malaj.** *"Monedha të Shkodrës të periudhës mesjetare"*, në konferencën "Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirë organizuar" organizuar nga Banka e Shqipërisë, me 8 Mars 2023.
12. **Edon Qesari.** *"Koncensione dhe qytetërim: Interesimi amerikan për burimet e nëntokës shqiptare gjatë vitet 1920"*, në konferencën shkencore "Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939", organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT), 14 dhjetor 2023.
13. **Eduart Caka.** *"Marrëdhëniet shqiptaro-turke në dimensionin e ndërveprimit shkencor me përqendrim tek fusha e historisë"* në aktivitetin e organizuar me rastin e 100 Vjetorit të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë, organizuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me ambasadën turke, Tiranë 20 Dhjetor 2023.
14. **Erjon Papagjoni.** *"Periudha e Monarkisë. Shteti si garant i integritetit dhe specifikës kombëtare të komuniteteve fetare"*, në konferencën shkencore "Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939", organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT), 14 dhjetor 2023.
15. **Gjon Boriçi.** *"Filluskat" financiare dhe impakti i tyre në historinë mesjetare nga rënia e Romës deri në shek. XIX"*, në konferencën IV Shkencore Ndërkombëtare "Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirëorganizuar", organizuar nga Muzeu i Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 8 shkurt 2023.
16. **Ledia Dushku.** *"Inxhinieria e ndërtimit të shtetit kombëtar: Ideja e Institutit Albanologjik dhe Muzeut Etnografik"*, në konferencën shkencore "Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939", organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT), 14 dhjetor 2023.
17. **Sali Kadria.** *"Marrëdhëniet shqiptaro-turke në vitet 1931-1935"* në Simpoziumin shkencor ndërkombëtar "Marrëdhëniet shqiptaro-turke, e kaluara, e tashmja, e ardhmja", organizuar në Tiranë nga Fondacioni ALSAR, 15-16 nëntor 2023.
18. **Sali Kadria.** *"Përpyjekjet për riorganizimin e forcave të xhandarmërisë në vitet e para të Monarkisë Shqiptare"*, në konferencën shkencore "Shqipëria mes dy luftërave botërore:

- aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939”, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Fakulteti i Drejtësisë (UT), 14 dhjetor 2023.
19. **Ylber Marku.** *“Socializmi i zbatuar: revolucioni ideologjik dhe kulturor në Shqipëri dhe mësimet e nxjerra nga historia”*, e mbajtur si pjesë e një cikli prej 8 leksionesh të hapura nën titullin *“Në Flakë të Revolucionit 1960-1970”*, 15 nëntor 2023.

C) KONFERENCA NË KOSOVË, MAQEDONINË E VERIU DHE MALIN E ZI

